



# 2014



## POLIOTIKAT E SIGURISË



Hekurudhat e Kosovës – Trainkos Sh.A  
Fushë Kosovë,  
Dhjetor 2014

## Përmbajtja:

• Dispozitat hyrëse.....	3
• Historiku i Hekurudhave të Kosovës - Trainkos Sh.A.....	3
• Përkushtimi i Hekurudhave të Kosovës - Trainkos Sh.A.....	4
• Zbatimi i Politikës së Sigurisë.....	4
• Përgjegjësit për zbatimin e Politikës së Sigurisë.....	6
• Kriteret dhe Objektivat e Politikës së Sigurisë.....	6
1. Ndërtimi i kapaciteteve dhe infrastrukturës efikase për menaxhimin e sigurisë.....	7
2. Aftësi profesionale dhe kualifikime.....	7
3. Organizimi dhe zhvillimi i sigurisë komunikacionit hekurudhor.....	7
4. Disiplina në punë.....	7
5. Informimi.....	7
6. Gjendja e infrastrukturës.....	7
7. Autorizimet dhe përgjegjësia.....	7
• Ngritja dhe përmirësimi i nivelit të sigurisë në komunikacionin hekurudhor .....	8
1. Kontrolli i zbatimit të rregullave për organizimin dhe rregullimin e komunikacionit hekurudhor.....	8
2. Aftësi profesionale.....	9
3. Qasja e përbashkët për zhvillimin e sigurisë .....	9
4. Hetimi i ngjarjeve të jashtëzakonshme. ....	9
• Konkluzionet.....	9

Në mbështetje të Nenit 20 të Ligjit 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe në bazë të nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për NP, Bordi i Drejtorëve i HK TRAINKOS SH.A në Mbledhjen Nr. 49 të mbajtur më 23 dhe më 29.12.2014, miratoi këtë:

## **Politika e Sigurisë - Trainkos Sh.A**

### **I. Historiku i Hekurudhave të Kosovës TRAINKOS Sh.A.**

Para 139 vitesh, gjegjësisht në vitin 1874 u ndërtua vija e parë Hekurudhore në Kosovë në relacionin Hani i Elezit – Fushë Kosovë – Mitrovicë. Ishte ky fillimi i shtrirjes së rrjetit Hekurudhor nëpër Kosovë, aq sa i rëndësishëm për transportin e Udhëtarëve dhe Mallrave, po aq i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe lidhjen e Kosovës me vendet e rajonit.

Në vitin 1931 vazhdoi ndërtimi i kësaj linje në relacionin Mitrovicë – Leshak, më 1934 Fushë Kosovë – Prishtinë, më 1936 Fushë Kosovë – Pejë, më 1949 Prishtinë – Podujevë – Livadhi dhe më 1963 Klinë – Prizren.

Kështu që sot rrjeti Hekurudhor i Kosovës shtrihet në tërë territorin e Kosovës me një gjatësi prej 333,451 km linjë e hapur Hekurudhore, me një gjatësi prej 105,784 km në stacione dhe 103,4 km vijë industriale. Rrjeti Hekurudhor i Kosovës përmes Leshakut dhe Podujevës në Veri dhe Lindje janë të lidhura me Serbinë, ndërsa përmes Hanit të Elezit, në jug me Maqedoninë.

Më poshtë është paraqitur në një formë të shkurtuar kronologjike historia e biznesit të TRAINKOS Sh.A: Ndërtimi i linjës së parë hekurudhore në vitin 1874, Që nga viti 1874 fillon Transporti i Mallrave me Hekurudhë i cili e zëvendëson transportin e deri atëherëshëm me kafshë. Hekurudhat zhvillohen shumë shpejt dhe një kohë të gjatë e mbajnë primatin e transportit të përgjithshëm tokësor.

Me fillimin e zhvillimit të industrisë për prodhimin e automjeteve transportuese rrugore, fillon edhe humbja e primatit të transportit me Hekurudhë. Por, prapë se prapë deri në vitin 1968 Hekurudha ishte transportuesi kryesor i mineraleve dhe prodhimeve të industrisë së rëndë.

Në integrimin e dhunshëm me Hekurudhat Serbe (Beogradit) në vitin 1990 e deri në vitin 1999 derisa ishte bllokada ekonomike e Serbisë, transporti me Hekurudhë zvogëlohet në mënyrë drastike. Menjëherë pas luftës në Kosovë, kompania është marrë nën kontroll nga ana e forcave të KFOR-it cilat forca kanë menaxhuar me kompaninë deri në vitin 2002.

Në vitin 2002 menaxhimi i kompanisë i është dorëzuar administratës së UNMIK-ut dhe nga kjo kohë kompania ka filluar të jetë e menaxhuar nga stafi civil. Me këtë rast Kompania është regjistruar me emrin Hekurudhat e UNMIK-ut pranë institucioneve përgjegjëse dhe ka filluar të transportojë mallra edhe për tregun komercial.

Pas vitit 2005 Kompania ka ndërruar statusin e saj ligjor dhe është formuar si Shoqëri Aksionare, ku edhe ka ndërruar emrin nga Hekurudhat e UNMIK-ut në Hekurudhat e Kosovës SH.A.

Nga viti 2005 deri në vitin 2011 (muaji shtator) kompania ka operuar me emrin Hekurudhat e Kosovës Sh.A. Nga muaji shtator 2011 Kompania Hekurudhat e Kosovës Sh.A quhet Hekurudhat e Kosovës TRAINKOS SH. A.

## **1. Përkushtimi i Hekurudhave të Kosovës Trainkos Sh.A**

**1.1.** Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.A. vëmendje të veçantë i kushtojnë sigurisë komunikacionit hekurudhore i cili tradicionalisht ka nivel të lartë sigurisë në krahasim me degët tjera të komunikacionit në vendin ton.

**1.2.** Më qëllim të avancimit, zhvillimit dhe ngritjes së nivelit të sigurisë, Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.A. nxjerrin këtë dokument të Politikës së sigurisë, i cili mbështet në Ligjin mbi Hekurudhat e Kosovës, Rregullores për Autorizimin e Sigurisë Nr 03/2012, Udhëzimet dhe aktet tjera nënligjore të zbatueshme në Trainkos Sh.A.

**1.3.** Krijimi i kushteve për zhvillimin të sigurt në operim dhe zhvillimin e sistemit për mbikëqyrjen e sigurisë në operimin me trena, përveç Politikës së sigurisë, në këto kushte ndikojnë edhe këto kritere:

- Niveli i sigurisë së komunikacionit hekurudhor.
- Përdorimi i teknikës ekzistuese, teknikës së re, sigurimi i standardeve dhe kushteve të përshtatshme për shfrytëzimin racional të kapaciteteve mobile, pajisjeve dhe stabilimenteve në funksion të zhvillimit të transportit;
- Hartimi, miratimi dhe implementimi i një manuali gjithëpërfshirës mbi sigurinë, Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë bazuar në praktikatat më bashkëkohore të menaxhimit të sigurisë nga operuesit e trenave.
- Vlerësimi i rrezikut dhe masat për kontrollin e rrezikut;
- Shkollimi – trajnimi i kuadrit profesional;
- Informimi; dhe
- analiza e ngjarjeve të jashtëzakonshme dhe marrja e masave të domosdoshme për parandalimin dhe evitimin e shfaqjes së tyre;

**1.4.** *Në përputhje me kompetencat që kanë, qoftë në vendimmarrje, zbatim dhe mbikëqyrje në fushën e sigurisë*, Menaxhmenti i Trainkos-it, konkretisht Departamenti i Operimeve në bashkëpunim me Zyrën për Kontroll/Siguri dhe Kualitet, e cila është në kuadër të Kabinetit të Kryeshefit si dhe dikasteret tjera relevante janë përgjegjës për zbatimin e politikës së sigurisë në rrjetin hekurudhor të Hekurudhave të Kosovës.

## **2. Zbatimi i politikës së sigurisë**

Përgjegjësit e politikës së sigurisë në aspektin hierarkik, drejtpërdrejt reflektojnë në infrastrukturë dhe në njësit shërbyese të këtij procesi. Në këtë këndvështrim duhet krijuar sistemin e kontrollit mbi zbatimin e rregullave të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e komunikacionit hekurudhor, për të cilën gjë përgjegjës është Menaxhmenti i Infrakosit dhe Trainkos-it, që ka të bëjnë më:

- Zbatimin rregullave për organizimin dhe mënyrën e realizimit të kontrollit mbi zhvillimin e sigurt të komunikacionit hekurudhor;
- Mbikëqyrjen e sigurisë, dhe
- Zbatimin e vendimeve të Menaxhmentit të Trainkos-it

Zbatimi i rregullores mbi organizimin dhe mënyrën zbatimit të kontrollit mbi zhvillimin e sigurt të komunikacionit hekurudhor, rregullon:

- Zbatimin e procesit të punës;
- Punën e punonjësve mbikëqyrës;
- Zbatimin e rregullave teknike të komunikacionit;
- Udhëheqjen e evidencave të parashikuara, dhe
- Hetimin e ngjarjeve të jashtëzakonshme.

Më menaxhimin e sigurisë nënkuptojmë:

- Ngritjen e nivelit dhe përmirësimin e sigurisë;
- Vlerësimin e rreziqeve;
- Informimi, dhe
- Auditimin e brendshëm.

Në këtë drejtim Menaxhmenti i Trainkos-it, është përgjegjës për:

- Aftësimin profesional të punonjësve në shërbimin ekzekutiv;
- Aftësitë shëndetësore të punonjësve në shërbimin ekzekutiv;
- Mbrojtja nga zjarri dhe
- Planet e veprimit për sezonin e dimrit.

**2.1.** Menaxhmenti i Trainkos-it nëpërmjet departamentit të Operimeve, është përgjegjës për veprimet operative dhe zbatimin e rendit të lëvizjes së trenave.

Proceset e punës së drejtpërdrejt i kryejnë punonjësit në shërbimin ekzekutiv të cilat kanë të bëjnë me aktivitetet e ndërlidhur me zhvillimin e sigurt të transportit, e këto janë:

- Zhvillimin, organizimin dhe rregullimin e sigurt të Levizjes së trenave në komunikacionin hekurudhor ;
- Zbatimi i rregullave teknike për operim në komunikacion dhe transport;
- Mirëmbajtja e kapaciteteve të mjeteve lëvizëse;
- Mirëmbajtja e objekteve për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse,
- Mirëmbajtja e mekanizmit për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse.

Më punën e njësive shërbyese, nënkuptojmë përshkrimin e organizimit të punës, analizën e shpërfilljeve të konstatuara gjatë mbikëqyrjes së drejtpërdrejt dhe marrja e masave për evitimin, mënjanimin dhe eliminimin e tyre.

Puna operative, përfshinë të gjitha shërbimet të cilat marrin pjesë në procesin e lëvizjes së trenave, në të cilën në mënyrë të drejtpërdrejt ose indirekte ndikojnë në sigurinë, mbarëvajtjen dhe zbatimin racional të rendit të lëvizjes së trenave. Planifikimi dhe hartimi i Orarit të lëvizjes së trenave është pjesë e punës së përbashkët me Infracos-in për qasje në infrastrukturë, ndërsa zbatimi i Orarit të lëvizjes së trenave është pjesë e punës së Trainkos-it.

Shpërfillje që mund të ndikojnë në siguri, gjatë zbatimit të orarit të levizjen së trenave OLT, mund të konsiderohen ;

- Mos zbatimi i rregullave teknike të komunikacionit;

- Mos planifikimi real i lëvizjes, dhe nisjes së trenave (lëvizja e planifikuar dhe reale e nisjes së trenave (vendi, shkaku dhe shpërfilljet kohore);
- Planifikimi jo i rregullt për formimin dhe shformimin e trenave, dhe
- Mos shfrytëzimi racional i kapaciteteve mobile.

### **3. Përgjegjësit për zbatimin e politikës së sigurisë**

*Varësisht nga niveli i përgjegjësisë qoftë në vendimmarrje, në zbatim apo mbikëqyrje, përgjegjës për zbatimin e politikës së sigurisë janë :*

- Menaxhmenti i Trainkos Sh.A
- Departamenti i Operimeve
- Zyra e Kontrollit /Sigurisë dhe Kualitetit

Detyra dhe përgjithësitë për zbatimin e politikave të sigurisë në mënyrë të detajuar, do të precizohen në manualin për sistemin e menaxhimit të sigurisë SMS.

Zbatuesit e politikës së sigurisë në komunikacionin hekurudhor, janë përgjegjës për zbatimin, mbikëqyrjen dhe arritjen e qëllimeve të caktuara për zhvillimin, organizimin dhe rregullimin e sigurt të komunikacionit hekurudhor në Trainkos Sh.A.

### **4. Kriteret dhe Objektivat e politikës së sigurisë**

Kriteret e politikës së sigurisë janë të ndara dhe të caktuara:

1. Rregullat themelore për organizimin sigurisë në operimin me trena në komunikacionit hekurudhor dhe
2. Përgjegjësia e zbatuesve të politikës së sigurisë në operimin me trena në komunikacionit hekurudhor.

Objektivat e politikës së sigurisë janë:

- Ndërtimi kapaciteteve dhe infrastrukturës efikase për menaxhimin e Sigurisë
- Aftësimi profesional i punonjësve në të gjitha nivelet;
- Organizimi dhe zhvillimi i sigurt komunikacionit hekurudhor
- Gjendja e infrastrukturës;
- Disiplina në punë;
- Informimi;
- Autorizimet dhe përgjegjësit.

**4.1. Ndërtimi kapaciteteve dhe infrastrukturës efikase për menaxhimin e Sigurisë,** nënkupton përcaktimin e qartë përgjithësive dhe masave që paraprakisht mundësojnë ndërtimin e një infrastrukture efikase në menaxhimin e Sigurisë, kjo si praktik mundësohet nëpërmjet ndërtimit të një manuali gjithëpërfshirës të menaxhimit të Sigurisë.

**4.2. Aftësimi profesional i punonjësve**, bazohet në aftësimin profesional i punonjësve në shërbimin ekzekutiv, i cili bazohet në Rregulloren mbi Përgatitjen Profesionale.

Aftësimi profesional nënkupton shkollimin e rregullt dhe verifikimin e njohurive të punonjësve në shërbimin ekzekutiv.

**4.3. Organizimi dhe zhvillimi i sigurt komunikacionit hekurudhor**, bazohet në organizimin, rregullimin dhe zhvillimin e sigurt, normal dhe të pa penguar të komunikacionit hekurudhor. Me zhvillimin e sigurt të komunikacionit hekurudhor nënkuptojmë ngërthimin e elementeve themelore të infrastrukturës hekurudhore më kapacitetet mobile dhe njeriun, respektimin e rendit të lëvizjes së trenave, procesin teknik - teknologjik të punës dhe respektimin e dokumentit teknik të stacioneve.

Zbatimi dhe mbikëqyrja profesionale e përtëritjes, rikonstruksionit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe kapaciteteve mobile të hekurudhës, janë faktorët dominant të cilët ndikojnë në zhvillimin normal dhe të sigurt të komunikacionit hekurudhor.

**4.4. Disiplina në punë**, bazohet në zbatimin e disiplinuar të detyrave të pranuar në të gjitha segmentet e brendshme të kompanisë Trainkos Sh. A.

**4.5. Gjendja e infrastrukturës** nënkupton ripërtëritjen, modernizimin dhe mbajtjen e nivelit të kërkuar të gjendjes së mirë teknike të gjitha elementeve teknike të infrastrukturës dhe kapaciteteve teknike të mjeteve lëvizëse..

**4.6. Informimi**, bazohet në caktimin e subjekteve, raportet e tyre reciproke në sferat e caktuara për këmbimin e informatave të shkruara dhe gojore.

**4.7. Autorizimet dhe përgjegjësia**, bazohen në ndërlidhjen e qartë të autorizimeve të dhëna dhe përgjegjësia e bartësve të politikës së sigurisë.

## **5. Ngritja dhe përmirësimi i nivelit të sigurisë në komunikacionin hekurudhore**

Me politikën e sigurisë, caktohen objektive konkrete për mënyrën organizimit për mirëmbajtjen dhe ngritjen e nivelit të sigurisë, në këto fusha të veprimit:

- Kontrolli i zbatimit të rregullave të komunikacionit dhe standardeve të cilat ndikojnë në sigurinë e komunikacionit hekurudhor;
- Aftësitë profesionale dhe shëndetësore të punonjësve në shërbimin ekzekutiv;
- Qasja e përbashkët për zhvillimin e sigurisë në transportin hekurudhor;
- Ngjarjet e jashtëzakonshme – analizat periodike dhe vjetore;
- Informimi, dhe
- Analizat e brendshme.

### **5.1. Kontrolli i zbatimit të rregullave për organizimin dhe rregullimin e komunikacionit hekurudhor**

Organizimi dhe rregullimi i komunikacionit hekurudhor, mbështetet në këto ligje:

- Ligji mbi sigurinë e komunikacionit *Rrugor*; (Ligji Nr. 02/L-70)
- Ligjin mbi Hekurudhat e Kosovës ; (Ligji NR. 04/L-063)
- Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. (Ligji NR. 04/L-161 )

- **Ligji për Transportin e mallrave te rrezikshme (Ligji Nr. 2004/6)**
- **Ligji për mbrojtjen nga zjarri . ( ligji Nr 04/L-012)+**

Përveç ligjeve të theksuara më sipër, në zbatim janë edhe aktet nënligjore, Rregulloret dhe Udhëzimet të cilat kanë të bëjnë me:

- Organizimin dhe rregullimin e komunikacionit hekurudhor;
- Gjendjen, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen mjeteve lëvizëse.
- Transportin e materieve të rrezikshme;
- Ngjarjet e jashtëzakonshme, dhe
- Punët e përgjithshme, punët juridike, resurset njerëzore, dhe punët tjera.

Me dispozitat e këtyre ligjeve dhe akteve nënligjore, rregulloret dhe udhëzimet e zbatueshme në Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.A. punonjësit e shërbimit operativ, njoftohen gjatë shkollimit të rregullt, por si pas nevojës edhe shkollimit të jashtëzakonshëm. Përveç kësaj, për qëllimet e theksuar më sipër mund të organizohen punëtori dhe seminare.

Kontrolli i zbatimit të rregullave të sigurisë, zbatohet përmes:

- Kontrollit të drejtpërdrejt mbi procesin e punës,
- Kontrolli në njësit e shërbimeve,
- Kontrolli operativ
- Kontrolli i organizimit dhe zhvillimit të sigurt të komunikacionit hekurudhor.

## **5.2. Aftësimi profesional**

Aftësimi profesional përmes shkollimit të rregullt të punonjësve në shërbimin ekzekutiv, është njëri prej qëllimeve më me prioritet i politikës së sigurisë në Trainkos Sh.A.

Aftësia profesionale verifikohet përmes verifikimit të rregullt dhe të jashtëzakonshëm të njohurive, ndërsa mbajtja e nivelit të lartë të aftësisë profesionale arrihet përmes shkollimit të rregullt dhe të jashtëzakonshëm.

Qëllimet e politikës së sigurisë lidhur me aftësimin profesional të punonjësve në shërbimin ekzekutiv, definojnë në bazë të programit vjetor të shkollimit, dhe qasjes së domosdoshme në përmbajtjet e reja.

## **5.3. Qasja e përbashkët për zhvillimin e sigurisë**

Qasja në lidhje me zhvillimin e sigurisë në komunikacionin hekurudhor e cila ka të bëjë me organizimin, rregullimin dhe zhvillimin e sigurt të komunikacionit hekurudhor, ka për qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e sigurisë së komunikacionit hekurudhor.

## **5.4. Hetimi i ngjarjeve të jashtëzakonshme**

### **Hetimi i ngjarjeve të jashtëzakonshme**

Duke u bazuar në dispozitat e *Ligjit në fuqi për Hekurudhat e Kosovës, ( Ligji Nr. 04/L-063 Nënkreu VI, Neni 31, faqe 20)* – Organi për hetimin e aksidentit operatori është i obliguar të organizojnë dhe zbatojnë hetimin e ngjarjeve të jashtëzakonshme. Ndërsa për hetimin e fatkeqësive serioze, si dhe ngjarjet e jashtëzakonshme të cilat për shkak të rrethanave të caktuara, shkaktojnë fatkeqësi serioze, në hetuesi marrin pjesë edhe organet kompetente të hetuesisë.



Qëllimet e politikës së sigurisë në Trainkos Sh. A, të cilat kanë të bëjnë me ngjarjet e jashtëzakonshme, janë të definuara me:

- Rregulloren mbi ngjarjet e jashtëzakonshme në transportin hekurudhor dhe – (*Është rregullorja e komunikacionit 19*)
- Udhëzimet për punë, veprim teknik – teknologjik dhe rregullat për veprim me ndodhjen e ngjarjes së jashtëzakonshme – (*është udhëzimi 79*)

## 6. Konkluzionet

Zbatimi i dispozitave të politikës së sigurisë të cilat për çdo vit caktohen me Politikën e sigurisë së transportit hekurudhor të Trainkos Sh.A, përbëhet prej:

- Qëllimeve vjetore të politikës së sigurisë,
- Masave dhe instrumenteve për zbatimin e qëllimeve të politikës së sigurisë, dhe
- Caktimi i bartësve të përgjegjësive për politikën e sigurisë dhe zbatimin e politikave të sigurisë.

Kjo politikë hyn në fuqi me 01.01.2015



Heset ÇAKOLLI

Kryesues i Bordit të HK-Trainkos Sh.A.